REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Niko PELESHI

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Autoritetit të Konkurrencës në sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar;

Duke njohur rëndësinë e Autoritetit të Konkurrencës si institucion i pavarur në monitorimin, hetimin dhe analizimin e tregjeve me ndikim në ekonominë kombëtare, funksionimin e tregut dhe mirëqenien e konsumatorëve;

Duke konsideruar rekomandimet e progresraportit të Bashkimit Europian për forcimin e zbatimit të rregullave të konkurrencës, si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit mbi këto rregulla;

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2025 në drejtim të:

Zhvillimit të 18 monitorimeve në tregje të ndryshme; 7 procedurave hetimore; shqyrtimit të 83 ankesave, nga të cilat 3 kanë sjellë aktivizimin e procedurave të monitorimit; trajtimit të 2 rasteve në kuadër të përjashtimit nga ndalimi i marrëveshjeve; njoftimit të 71 transaksioneve, nga të cilat 58 kanë kaluar në procedurat e kontrollit të përqendrimeve dhe janë autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës; si dhe dhënies së mendimit për 17 projektakte dhe vlerësimit të 26 projektakteve normative të enteve rregullatore.

Ushtrimit të funksioneve ligjore në mbrojtje të konkurrencës së lirë dhe efektive përmes monitorimeve, hetimeve, kontrollit të përqendrimeve dhe vendimmarrjes së Komisionit të Konkurrencës;

Monitorimit të një game të gjerë tregjesh me ndikim në ekonomi dhe te konsumatori, përfshirë tregje të ndjeshme si: produktet ushqimore, shërbimet bankare, sigurimet, shërbimet celulare, shërbimi spitalor, transporti, barnat dhe produktet e shportës ushqimore;

Hapave të ndërmarrë në drejtim të përafrimit të kuadrit ligjor dhe praktikës institucionale me standardet e Bashkimit Europian, përfshirë hartimin e ndryshimeve në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar;

Ushtrimit aktiv të funksionit të vlerësimit të akteve dhe projektakteve normative, veçanërisht në sektorë të rregulluar dhe me ndikim te konsumatori, si: komunikimet elektronike, energjia, gazi dhe furnizimi me ujë;

Kuvendi rekomandon që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2026 të përmirësojë punën në këto drejtime:

1. Të vijojë përafrimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor me standardet e Bashkimit Europian në përputhje me detyrimet e PKIE-së dhe praktikat më të mira europiane në fushën e konkurrencës.
2. Të prioritizojë tregjet që do t'i nënshtrohen monitorimit dhe hetimit, me qëllim rritjen e efikasitetit në përdorimin e burimeve institucionale dhe orientimin e ndërhyrjeve drejt tregjeve që paraqesin problematika më të theksuara ose pasoja më të drejtpërdrejta për konkurrencën dhe interesin publik.
3. Të përdorë në mënyrë efektive kompetencat ligjore për sigurimin e informacionit nga ndërmarrjet, palët e treta dhe institucionet publike, në përputhje me nenet 33 dhe 34 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar, dhe të intensifikojë bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse për kontrollin financiar, tatimet, doganat dhe entet rregullatore.
4. Të forcojë bashkëpunimin me autoritetet simotra të konkurrencës dhe të mbrojtjes së konsumatorit në përputhje me nenet 71 dhe 72 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar. Të përdorë në mënyrë aktive mekanizmat e shkëmbimit të informacionit me këto autoritete, veçanërisht për tregjet ku operojnë kompani ndërkombëtare, zinxhirë rajonalë furnizimi ose operatorë, që tregtojnë të njëjtat produkte në disa vende.
5. Të rrisë ndërgjegjësimin publik mbi përdorimin e instrumentit të ankesës dhe të hartojë formate standarde orientuese për qytetarët dhe bizneset. Në raportimin vjetor të pasqyrohen arsyet e pranimit ose mosshqyrtimit të ankesave, si dhe rastet kur ato kanë shërbyer si indicie për nisjen e monitorimeve apo hetimeve.
6. Të sigurojë monitorimin periodik të marrëveshjes për shkëmbimin e informacionit në tregun e sigurimeve TPL/MTPL dhe të garantojë konkurrueshmërinë, duke verifikuar që të dhënat e shkëmbyera të jenë vetëm statistikore, të përmbledhura dhe jo të dhëna të ndjeshme tregtare. Të vijojë bashkëpunimin me AMF në shkëmbimin e informacionit me qëllim mbajtjen nën vëmendje të shtuar të këtij tregu dhe parandalimin e çdo forme të koordinimit antikonkurrues dhe mbrojtjen e interesit të konsumatorëve.
7. Të hetojë tregun e hidrokarbureve duke analizuar strukturën e tregut, zinxhirin e furnizimit, formimin e çmimeve, rolin e ndërmjetësve tregtarë dhe sjelljen e operatorëve. Një raport mbi gjetjet dhe rezultatet e këtij hetimi të paraqitet në Kuvend brenda muajit shtator 2026.
8. Të monitorojë evolucionin e tregut të shërbimeve spitalore private duke analizuar nëse ka elemente të abuzimit me pozitën dominuese në treg, si dhe duke verifikuar nëse niveli i formalizimit, gjurmueshmëria e shërbimeve dhe pagesave, transparenca e tarifave dhe kontrolli rregullator janë të mjaftueshme për të parandaluar çmimet e tepruara dhe kufizimin e ofertës.
9. Të kryejë sa më parë një hetim të tregut të shërbimeve televizive me pagesë dhe platformave OTT/IPTV, duke analizuar strukturën e tregut, marrëdhëniet ndërmjet operatorëve, paketat e kanaleve dhe përdorimin e të drejtave ekskluzive të transmetimit. Hetimi të zhvillohet brenda afateve procedurale dhe me ritëm të përshpejtuar, në mënyrë që ndërhyrja e Autoritetit të mos humbasë efektivitetin dhe të parandalojë në kohë konsolidimin e praktikave të mundshme antikonkurruese në treg. Një raport mbi gjetjet dhe rezultatet e këtij hetimi të paraqitet në Kuvend brenda muajit tetor 2026

10. Të vijojë monitorimin e tregut të shërbimeve celulare, me fokus në strukturën duopolistike të tregut, sinkronizimin e çmimeve, ngjashmërinë e ofertave, transparencën e metodologjisë kosto–çmim dhe aplikimin e klauzolave të indeksimit me inflacionin. Në vijim të hetimit të thelluar të hapur me vendimin nr. 1226, datë 18.11.2025 "Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania sh.a. dhe One Albania sh.a. në tregun me pakicë të shërbimeve celulare", Autoriteti të raportojë në Kuvend mbi gjetjet, masat e ndërmarra dhe efektet për konkurrencën efektive dhe mbrojtjen e konsumatorit. Një raport mbi gjetjet dhe rezultatet e këtij procesi të paraqitet në Kuvend brenda muajit nëntor 2026.

11. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda 3 mujorit të tretë të vitit 2026.

12. Të angazhohet për përmbushjen e plotë të standardeve të transparencës institucionale në përputhje me Programin e Transparencës dhe rekomandimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke siguruar publikimin sistematik dhe të përditësuar të informacionit me interes publik.

13. Të konsolidojë mekanizmat e transparencës institucionale duke forcuar funksionin e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe duke garantuar publikimin e informacionit sipas standardeve të të dhënave të hapura dhe ripërdorimit të informacionit të sektorit publik

14. Të sigurojë zbatimin në kohë të rekomandimeve dhe vendimeve të institucioneve të pavarura, duke raportuar periodikisht çdo 4-muaj në Kuvend për masat e ndërmarra dhe statusin e zbatimit të tyre në përmbushje të detyrimeve institucionale, si dhe standardeve evropiane.

Miratuar në datën 30.6.2026